<b>Aktive materiale</b>			
<i>Toka dhe ndertesa</i>	8	55,985,056	55,985,056
<i>Nga kjo :Dhene me koncension</i>	8	9,652,000	9,652,000
<i>Ndertesa</i>	8	67,095,499	67,339,120
<i>Nga kjo :Dhene me koncension</i>	8	62,466,715	62,466,715
<i>Impiante dhe makineri</i>	8	46,381,763	47,520,590
<i>Nga kjo :Dhene me koncension</i>	8	41,826,456	41,826,456
<i>Te tjera installme dhe pajisje</i>	8	381,580	459,910
<i>Nga kjo :Dhene me koncension</i>	8	68,262	68,262
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>		<b>169,843,898</b>	<b>171,304,676</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>416,900,744</b>	<b>418,402,168</b>

Keto pasqyra te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese 1-21, ne vijim.

Pergatiti  
 Vilma Ballkaniku





## Pasqyra e Pozicionit Financiar

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënime	Periudha	Periudha
		Raportuese 31.12.2019	Para ardhwse 31.12.2018
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	9	1,997,264	405,932
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	10	354,940	350,940
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	11	55,664	101,126
<i>Te tjera te pagueshme</i>	12	12,944,331	7,951,529
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>			
<b>Te ardhura te shtyra</b>			
<b>Provizione</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>15,352,199</b>	<b>8,809,528</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
<b>Detyrime tatimore te shtyra</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime totale</b>		<b>15,352,199</b>	<b>8,809,528</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>			
<b>Kapitali i nenshkuar</b>	13	817,100,000	817,100,000
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>		42,927,360	42,927,360
<b>Fitimi/(humbja) e pashperndare</b>		(450,434,720)	(440,374,799)
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	18	(8,044,095)	(10,059,921)
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>		<b>401,548,545</b>	<b>409,592,640</b>
<b>Interesa jo-kontrollues</b>			
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>401,548,545</b>	<b>409,592,640</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>416,900,744</b>	<b>418,402,168</b>

Keto pasqyra te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese 1-21, ne vijim

Pergatiti  
 Vilma Ballkaniku



**Pasqyra e Performances (sipas natyres)**

	Shënime	Periodha Raportuese Viti 2019	Periodha Para ardhvise Viti 2018
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>			
<i>Te ardhurat nga shitja e inventarëve</i>	14	232,185	0
<i>Te tjera te ardhura nga qiradhnia</i>	14	1,078,632	1,043,042
<b>Te ardhura nga grantet</b>	14	6,109,449	7,000,000
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme</b>			
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme</i>	15	(496,081)	(314,778)
<i>Te tjera shpenzime</i>			
<b>Shpenzime te personelit</b>			
<i>Paga dhe shperblime</i>	16	(7,810,709)	(8,004,000)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	16	(1,304,388)	(1,346,688)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>			
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>			
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	8	(1,460,777)	(1,777,888)
<i>Shpenzime te tjera shfrytezimi</i>	17	(4,392,406)	(6,659,609)
<b>Te ardhura te tjera</b>			
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>			
<b>Shpenzime financiare</b>			
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet te tjera (pershkruaj)</b>			
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		(8,044,095)	(10,059,921)
<b>Tatimi mbi fitimin</b>			
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	18	0	0
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>			
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>			
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>	18	(8,044,095)	(10,059,921)
<b>Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per periudhen/vitin:</b>			
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen/vitin (B)</b>		0	0
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per periudhen/vitin (A+B)</b>	21	(8,044,095)	(10,059,921)

Keto pasqyra te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese 1-21, ne vijim.

Pergatiti  
 Vilma Ballkaniku



Shoqëria "Kombinati Energjitik" Sh.A., në likuidim  
Pasqyrat financiare të vitit 2019  
Vlerat janë paraqitur në LEKE

---

**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)**

	Periodha Raportuese 2019	Periodha Raportuese 2018
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit:</b>		
Fitimi/(Humbla) e periudhës	(8,044,095)	(10,659,921)
<i>Rregullime për shpenzimet jo-monetare:</i>	41,492	
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime për tatimin mbi fitimin jo-monetar (diferenca shpenzimi - pagese gjate periudhës)		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,460,777	1,777,888
<b>Ndryshim në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit</b>		
Rritje/(Rritje) në të drejtat e arketueshme dhe të tjera	(3,580,669)	(1,045,861)
Rritje/(Rritje) në inventar	229,061	0
Rritje/(Rritje) në detyrime të pagueshme	6,542,642	264,641
Rritje/(Rritje) në detyrime për punonjësit		
Të tjera (detyrime për Tatime)	(41,462)	5,555
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(3,392,254)</b>	<b>(9,057,698)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur në aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Para të perdorura për blerjen e filjaleve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të blera)		
Para të arketuara nga shitja e filjaleve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të shitura)		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arketime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividende të arketuar		
Interesa të arketuara		
Të tjera (përkrahje)		
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e investimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur në aktivitetin e financimit</b>		
Arketime nga emetimi i kapitalit të nënshkruar		
Arketime nga emetimi i aksioneve të perdorura si kolateral		
Hua të arketuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhet me kredite dhe huatë		
Ritërtje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të perdorura si kolateral		
Pagesa e huave		
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		
Interes i paguar		
Dividende të paguar pronarëve të njesive ekonomike mëmë		
Dividende të paguar interesave jokontrrollues		
Të tjera (përkrahje)		
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e financimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Rritje/(reale) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me të</b>	<b>(3,392,254)</b>	<b>(9,057,698)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me të në fillim	6,566,376	15,624,074
Efëkti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare		
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me të në fund</b>	<b>3,174,122</b>	<b>6,566,376</b>

Këto pasqyra të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 1-21, në vijim.

0	0
(3,392,254)	(9,057,698)
6,566,376	15,624,074
3,174,122	6,566,376


**Shoqëria "Kombinati Energjitik" Sh.A., në likuidim**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**  
**Vlerat janë paraqitur në LEKE**

**Pasqyra e levizjeve në kapitalin neto**

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Fitimet/ (humbjet) e pasqyrore	Fitim/(humbja ) e periudhës	Total	Interesa jo- kontrollues	Total
<b>Pozicioni financiar 31.12.2017</b>	<b>817,100,000</b>	<b>42,927,360</b>	<b>(440,374,799)</b>		<b>419,652,561</b>		<b>419,652,561</b>
Efëkti i ndryshimeve në politikat kontabile					0		0
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar në fillim</b>	<b>817,100,000</b>	<b>42,927,360</b>	<b>(440,374,799)</b>	0	<b>419,652,561</b>	0	<b>419,652,561</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:</b>					0		0
Fitim/(humbja) e periudhës				(10,059,921)	(10,059,921)		(10,059,921)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					0		0
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në kapital					0		0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhën</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>(10,059,921)</b>	<b>(10,059,921)</b>	<b>0</b>	<b>(10,059,921)</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					0		0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0		0
Dividende të shpërndara					0		0
Porsaktime të tjera për rezultatit e periudhës (përshtuar)					0		0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar 31.12.2018</b>	<b>817,100,000</b>	<b>42,927,360</b>	<b>(440,374,799)</b>	<b>(10,059,921)</b>	<b>409,592,640</b>	0	<b>409,592,640</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:</b>					0		0
Fitim/(humbja) e periudhës				(8,044,095)	(8,044,095)		(8,044,095)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					0		0
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në kapital					0		0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhën</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>(8,044,095)</b>	<b>(8,044,095)</b>	<b>0</b>	<b>(8,044,095)</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					0		0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0		0
Dividende të shpërndara					0		0
Kalimi i humbjes së vitit tek humbjet e mbartara			(10,059,921)	10,059,921	0		0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>(10,059,921)</b>	<b>10,059,921</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar 31.12.2019</b>	<b>817,100,000</b>	<b>42,927,360</b>	<b>(450,434,720)</b>	<b>(8,044,095)</b>	<b>401,548,545</b>	0	<b>401,548,545</b>

Kjo pasqyra të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 1-21, në vijim.

Pergatiti  
 Vilma Ballaoniku




## SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

### 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Kombinati Energjitik" shoqëri aksionare në likuidim, është një shoqëri shtetërore, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të shoqërive tregtare me datë 01/07/1996, me numër unik të identifikimit J62903209H dhe adresë në Rajonin e Metalurgjisë në Elbasan.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat si dhe ligjet e industrisë ku operon shoqëria.

Objekti i veprimtarisë: Gjatë vitit 2019 shoqëria ka kryer veprimtari mjaft të kufizuar në fushën qiradhënies dhe tregëtisë së inventarëve qarkullues, pronë e saj.

Kapitali i regjistruar: Vlera e kapitalit me 31 Dhjetor 2019 është 817.100.000 Lekë (31.12.2018: 817.100.000 Lekë) dhe përbëhet nga 817.100 aksione me vlerë nominale 1.000 Lekë për aksion.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila zotëron 100 % të kapitalit të Shoqërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë: Zj. Irena Malolli; zj. Belina Memeti dhe zj. Elona Mistrovica.

Shoqëria drejtohet nga likuidatori z.Kadri Salla, me të drejta, detyra, të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe në aktin e emërimit.

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë pronësi të shoqërisë.

Me datë 31 Dhjetor 2019 shoqëria kishte 10 punonjës, ndërsa 11 ishte numri mesatar i punonjesve për vitin 2019.

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"). Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me efekt nga data 1 janar 2019.

#### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### 2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("LEKE"), e cila është monedha funksionale apo e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron Shoqëria. Monedha e paraqitjes është Lek shqiptar ("LEKE"). Të gjitha vlerat janë rumbullakosur në Lek, përveçse ku shprehet ndryshe.

#### 2.4 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria nuk është në kushtet e vijimësisë, pasi në bazë të urdhrit të aksionarit të vetëm nr. 4299 datë 26.05.2015, është vendosur për prishjen e Shoqërisë dhe fillimin e procedurave të likuidimit. Si rrjedhim shoqëria nuk mund të vazhdojë të përgatisë pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

### 3.1 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.

Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësi ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### 3.2 Shitja e materialeve

Të ardhurat nga shitja e mallrave, materialeve dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) njësi ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;

(b) njësi ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;

(c) shumat e të ardhurave mund të maten me besueshmëri;

(d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësi ekonomike;

(e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

### 3.3 Kontratat e shërbimit

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

### 3.4 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësi ekonomike nuk prëft përfitime të ardhshme, njihen menjëherë në rezultatit financiar.

### 3.5 Transaksionet e qirase

Qiraja është një marrëveshje ku qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një aktivi për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt një ose disa pagesave. Marrëveshjet e qirasë janë klasifikuar si qira e

zakonshme. Faktori përcaktues për klasifikimin e qirave është niveli deri ku rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e një aktivi të dhënë me qira i takojnë qiramarrësit apo qiradhënësit.

### 3.6 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

### 3.7 Aktivët financiarë

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje

### 3.8 Detyrimet financiare

Ne kete grup jane perfshire detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjesve, administrates tatimore, kreditorëve të tjere, etj. Ne njohjen fillestare zerat e ketij grupi jane vleresuar me kosto. Ne fund te vitit detyrimet vleresohen sipas rastit me kosto apo me kosto te amortizuar, duke perdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Kompensimi

Aktivët dhe Detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

### 3.10 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, si pjesë e aktiveve financiare, përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara ose me maturitet tre muaj ose më pak, të percaktuara si më sipër.

### 3.11 Detyrime/të drejta tatimore

Si pjesë e një aktivi apo detyrimi financiar, të drejtat dhe detyrimet tatimore përfshijnë të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të paguara dhe për tu paguar ndaj administrates tatimore, të cilat vleresohen me kosto (me vlerë të paskontuar). Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontojnë dhe nuk zhvlerësohen.

### 3.12 Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale (AAM dhe AAJM)

Aktivët afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësia ekonomike për qëllime administrative apo për t'iu dhënë me qira palëve të treta, për më shumë se një periudhë kontabël. Aktivët afatgjata materiale maten me kosto dhe paraqiten në pasqyrat financiare me vlerë neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka klasifikuar si aktive afatgjata materiale, inventarët që përbëhen nga toka, ndërtesa, pajisje pune e pajisje informatike, mobilje e pajisje zyre, shumë të amortizuara. Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në kushtet normale për funksionimin e tij.

~ M 1



Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërise, është metoda e vlerës së mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë paraqitur në tabelën më poshtë, ku vlen të theksohet që për vitin 2019 shoqëria nuk ka ndryshuar normat e amortizimit.

Pershkrimi	Norma vjetore	Metoda
Ndërtesa	5%	Me vlerë e mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlerë e mbetur
Mobilje e orendi	20%	Me vlerë e mbetur
Pajisje pune	20%	Me vlerë e mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlerë e mbetur

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Tokat dhe Aktivet në proces nuk amortizohen.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

### 3.13 Provizionet

Provizioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose kontraktual dhe nëse ekziston mundësia që të kërkolet një dalje burimesh ( përfitimet ekonomike) për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim

### 3.14 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

### 3.15 Kapitali

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga aksionet e kapitalit, të cilat i përkasin 100% aksionarit të vetëm, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kapitali njihet me kosto, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërise.

### 3.16 Tatimi mbi të ardhurat

Tatim fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkt në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

#### 1. Mjete monetare dhe të ngjashme

Gjendjet e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten të detajuara si më poshtë:

Shoqëria "Kombinati Energjistik" Sh.A., në likuidim  
Pasqyrat financiare të vitit 2019  
Vlerat janë paraqitur në LEKE

Llogari ne banke	31.12.2019	31.12.2018
Raiffeisen Bank	41,885	1,333,914
Banka Kombetare Tregtare	3,132,237	5,232,462
<b>Total mjete monetare</b>	<b>3,174,122</b>	<b>6,566,376</b>

Vlera e mesiperme perfaqeson vleron e likuiditeteve me date 31.12.2019, gjendje ne llogarite qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne Lekë. Gjendja e likuiditeteve (ne banke) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.

2. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Nr	Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
1	N.P.Ç Elbasan	100,887,883	100,887,883
2	Uzina e Ferrokromit Elbasan	76,459,858	76,459,858
3	Uzina e Materialeve Refraktare Elbasan	3,168,925	3,168,925
4	Nd/ja Prodhim Mat.Ndertimit Elbasan	3,035,995	3,035,995
5	Uzina Karbonike Elbasan	2,970,430	2,970,430
6	Nd/ja Ujesjelles Elbasan	1,064,359	1,064,359
7	Nd/ja Fnergjitike Elbasan	866,144	866,144
8	Konsumator familjar telefoni Qendra Spitalore Universitare Tirane	760,387	760,387
9	Firma "Jundrit" Elbasan	138,407	341,849
10	Firma "Sofigaz" Tirane	264,483	264,483
11	Firma Ferros PIVMENTS	259,839	259,839
12	Firma SIL-ALB	234,541	234,541
13	TEL-KOM Elbasan	228,719	228,719
14	Firma "Minal" Elbasan	226,319	226,319
15	Rajoni hekurudhor Elbasan	214,780	214,780
16	Debitore per qirane per Vitin 2019	204,797	204,797
17	Spitali Gramsh	203,442	114,056
18	Spitali Kukes	172,235	172,235
19	Spitali Gjirokaster	143,153	143,153
20	Adnan Rexha	141,740	141,740
21	Spitali Sarande	140,400	140,400
22	Spitali Tropoje	133,658	133,658
23	Firma "Besa" Elbasan	117,080	117,080
24	Firma "Albaroad" Elbasan	111,400	111,400
25	Spitali Vlore	99,828	99,828
26	Spitali Korçe	97,901	97,901
27	Uzina Ferrokromit Burrel	87,782	87,782
28	Firma "Klajdi" Elbasan	86,826	86,826
29	Firma "Liria"	84,031	84,031
30	Remonti Elektrik Sh.A Elbasan	77,160	77,160
31	TEL-KOM Elbasan	72,239	72,239
32	Firma "Darfo -Albania"	70,040	
33		64,662	64,662

Shoqëria "Kombinati Energjitik" Sh.A., në likuidim  
 Pasqyrat financiare të vitit 2019  
 Vlerat janë paraqitur në LEKE

34	Firma "TERZIU"	64,040	64,040
35	ANMETAL Sh.p.k Durres	61,056	91,584
36	Uzina e Koksit Elbasan	60,879	60,879
37	I.S.P.M Elbasan	60,808	60,808
38	Firma "Stozab" Elbasan	59,813	59,813
39	Firma "Dervishi"	53,552	53,552
40	Dega e Postbllokut Elbasan	49,200	49,200
41	Firma "Gjevori" Elbasan	48,564	48,564
42	Spitali Erseke	45,482	45,482
43	ELBESA Sh.p.k Elbasan	41,661	20,808
44	Firma "Eurodrini" Elbasan	40,970	40,970
45	FA & Bi Elbasan	40,050	
46	Firma "Agro - Eva" Elbasan	39,000	39,000
47	Firma "Kumria" Elbasan	35,280	35,280
48	Firma "Mjeshtri" Elbasan	34,288	34,288
49	Spitali Puke	33,887	33,887
50	Spitali Kruje	33,540	33,540
51	Uzina Nr 12 Elbasan	28,220	28,220
52	Uzina Mekanike Kuçove	25,895	25,895
53	Filiali Elektromekanik Tirane	25,327	25,327
54	Uzina e Gizes Elbasan	24,611	24,611
55	Klubi Uzines Çelikut +Uzina Nr12	19,799	19,799
56	Spitali Librazhd	16,712	16,712
57	Reparti i Nderhyrjes Shpejte Tirane Klubi I.S.P.M. + Menca 1+2	16,690	16,690
58	Elbasan	15,907	15,907
59	Reparti Inspektim Shpetimeit Patos	15,360	15,360
60	Nd/ja Elektrike	14,880	14,880
61	Universiteti Elbasan	12,840	12,840
62	Firma "Ekspansion" Elbasan	12,540	12,540
63	Instituti Shendetit Publik Tirane	10,767	10,767
64	Spitali Pogradec	10,585	10,585
65	Spitali Kuçove	9,570	9,570
66	Reparti Ushtarak 80-42 Vlore	7,500	7,500
67	Spitali Skrapar	7,322	7,322
68	Dushku -E-K-SECURITY Elbasan	7,140	-60
69	Firma "Europa" Elbasan	6,792	6,792
70	Nd/ja Shpim Kerkimit Kuçove	6,720	6,720
71	Reparti Ndehyrjes Shpejte Fier	6,720	6,720
72	Universiteti Tirane	6,146	6,146
73	Firma "Koçi" Elbasan	3,600	3,600
74	Klubi i Uzines Nr 12 Elbasan	2,220	2,220
75	Rezervat e Shtetit Elbasan	1,770	1,770
76	Privat Safet Asllani	1,770	1,770
77	Klubi i Uzines Gizes Elbasan	1,620	1,620
78	Klubi Nr 12 +Uzina Mekanike Elbasan	960	960
79	EUROTRADE DISTRIBUTION TIRANE	4,532	

Shoqëria "Kombinati Energjitik" Sh.A., në likuidim  
Pasqyrat financiare të vitit 2019  
Vlerat janë paraqitur në LEKE

80	NIKITA Sh.p.k.Elbasan	-	11,973	1,724
81	Uzina Riparimit Avioneve Kuçove	-	12,323	-12,323
II	Rajoni i sherbimit hekurudhor Elbasan	-	25,728	-25,728
1	Uzina Gëzhde bullonave Kavaje	-	35,160	-35,160
2	Reparti Ushtarak 40-30 Kuçove	-	56,323	-56,323
3	Spitali Berat	-	67,086	-67,086
4	Spitali Burrel	-	85,201	-85,201
5	Kantjeri Detar Durres	-	145,286	-145,286
6	Spitali Elbasan	-	152,362	-152,362
7	Firma "Kurum"	-	394,017	-394,017
<b>TOTAL</b>			<b>193,021,505</b>	<b>192,932,119</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur të drejtat për tu arkëtuar, të vlerësuara me kosto dhe që janë krijuar para shumë vitesh. Me gjithë përpjekjet e shoqërisë nuk është bërë e mundur arkëtimi i tyre dhe po kështu nuk është kryer as zhvlerësimi i tyre për arsye të mospageses.

**3. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Kliente pa shprese arkëtimi	31,037,839	31,037,839
Provizione për kliente pa shprese arkëtimi	-31,037,839	-31,037,839
Debitore	12,199,036	12,199,036
Debitore personel i larguar	256,412	256,412
Debitore, kreditorë të tjerë	1,438,937	1,438,937
Debitore	417,267	417,267
Huadhënie afatshkurtër (N.P.Ç Elbasan)	3,000,000	0
TVSH për tu marrë	2,324,345	1,833,063
<b>TOTAL</b>	<b>19,635,998</b>	<b>16,144,715</b>

Debitoret për shumën 12,199,036 Leke  
Detyrim për tu sistemuar gjatë dorëzimit të Repartit Ujesjelles Fshat Elbasan

**4. Inventarët**

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Lende e pare dhe mat të konsumi	31,225,221	31,454,282
<b>TOTAL</b>	<b>31,225,221</b>	<b>31,454,282</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur gjendja e inventareve qarkullues, të cilat perbehen nga mallra e materiale të llojeve të ndryshme për shitje, të vlerësuara me kosto.

**Shoqëria "Kombinati Energjitik" Sh.A., në likuidim**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2019**  
**Vlerat janë paraqitur në LEK.£**

**8. Aktive afatgjata materiale**

KOSTO	Toka	Ndertesa	Instalime teknike	Mjeto transporti	Ta tjera AAM	Total
<b>Gjendje 31.12.2017</b>	<b>55,985,056</b>	<b>151,207,709</b>	<b>76,886,328</b>	<b>1,887,500</b>	<b>1,231,725</b>	<b>287,198,318</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	<i>9,652,000</i>	<i>135,315,900</i>	<i>65,764,973</i>	-	<i>263,088</i>	<i>210,995,961</i>
<i>pa koncension</i>	<i>46,333,056</i>	<i>15,891,809</i>	<i>11,121,355</i>	<i>1,887,500</i>	<i>968,637</i>	<i>76,202,357</i>
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	<b>55,985,056</b>	<b>151,207,709</b>	<b>76,886,328</b>	<b>1,887,500</b>	<b>1,231,725</b>	<b>287,198,318</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	<i>9,652,000</i>	<i>135,315,900</i>	<i>65,764,973</i>	-	<i>263,088</i>	<i>210,995,961</i>
<i>pa koncension</i>	<i>46,333,056</i>	<i>15,891,809</i>	<i>11,121,355</i>	<i>1,887,500</i>	<i>968,637</i>	<i>76,202,357</i>
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	<b>55,985,056</b>	<b>151,207,709</b>	<b>76,886,328</b>	<b>1,887,500</b>	<b>1,231,725</b>	<b>287,198,318</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	<i>9,652,000</i>	<i>135,315,900</i>	<i>65,764,973</i>	-	<i>263,088</i>	<i>210,995,961</i>
<i>pa koncension</i>	<i>46,333,056</i>	<i>15,891,809</i>	<i>11,121,355</i>	<i>1,887,500</i>	<i>968,637</i>	<i>76,202,357</i>
<b>AMORTIZIMI</b>						
<b>Gjendje 31.12.2017</b>	-	<b>(83,612,147)</b>	<b>(27,942,205)</b>	<b>(1,591,282)</b>	<b>(970,121)</b>	<b>(114,115,755)</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	-	<i>(72,849,185)</i>	<i>(23,938,517)</i>	-	<i>(194,826)</i>	<i>(96,982,528)</i>
<i>pa koncension</i>	-	<i>(10,762,962)</i>	<i>(4,003,688)</i>	<i>(1,591,282)</i>	<i>(775,295)</i>	<i>(17,133,227)</i>
Shtesa	-	<b>(256,442)</b>	<b>(1,423,533)</b>	<b>(59,244)</b>	<b>(38,668)</b>	<b>(1,777,887)</b>
Pakesime	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	-	<b>(83,868,589)</b>	<b>(29,365,738)</b>	<b>(1,650,526)</b>	<b>(1,008,789)</b>	<b>(115,893,642)</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	-	<i>(72,849,185)</i>	<i>(23,938,517)</i>	-	<i>(194,826)</i>	<i>(96,982,528)</i>
<i>pa koncension</i>	-	<i>(11,019,404)</i>	<i>(5,427,221)</i>	<i>(1,697,921)</i>	<i>(844,898)</i>	<i>(18,911,114)</i>
Shtesa	-	<b>(243,620)</b>	<b>(1,138,827)</b>	<b>(47,395)</b>	<b>(30,935)</b>	<b>(1,460,777)</b>
Pakesime	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje 31.12.2019</b>	-	<b>(84,112,209)</b>	<b>(30,504,565)</b>	<b>(1,697,921)</b>	<b>(1,039,724)</b>	<b>(117,354,419)</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	-	<i>(72,849,185)</i>	<i>(23,938,517)</i>	-	<i>(194,826)</i>	<i>(96,982,528)</i>
<i>pa koncension</i>	-	<i>(11,263,024)</i>	<i>(6,566,048)</i>	<i>(1,697,921)</i>	<i>(844,898)</i>	<i>(20,371,891)</i>
<b>Vlera neto 31.12.2018</b>	<b>55,985,056</b>	<b>67,339,120</b>	<b>47,520,590</b>	<b>236,974</b>	<b>222,936</b>	<b>171,304,676</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	<i>9,652,000</i>	<i>62,466,715</i>	<i>41,826,456</i>	-	<i>68,262</i>	<i>114,013,433</i>
<i>pa koncension</i>	<i>46,333,056</i>	<i>4,872,405</i>	<i>5,694,134</i>	<i>189,579</i>	<i>123,739</i>	<i>57,291,243</i>
<b>Vlera neto 31.12.2019</b>	<b>55,985,056</b>	<b>67,095,500</b>	<b>46,381,763</b>	<b>189,579</b>	<b>192,001</b>	<b>169,843,899</b>
<i>Nga kjo: me koncension</i>	<i>9,652,000</i>	<i>62,466,715</i>	<i>41,826,456</i>	-	<i>68,262</i>	<i>114,013,433</i>
<i>pa koncension</i>	<i>46,333,056</i>	<i>4,628,785</i>	<i>4,555,307</i>	<i>189,579</i>	<i>123,739</i>	<i>55,830,466</i>

**9. Të pagueshme ndaj furnitorëve dhe të tjera**

Shoqëria ka detyrime të pagueshme me 31.12.2019 dhe 31.12.2018, në vlerat si në vijim:

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Furnitore	1,580,113	32,317
Garanci kontrate	138,621	94,110
Kreditore të tjera	278,529	279,505
<b>TOTAL</b>	<b>1,997,264</b>	<b>405,932</b>

Në rubrikën furnitorë janë paraqitur detyrimet ndaj shoqërisë Dushku -E-K Elbasan, për ruajtjen e objekteve.

Firma "ELBESA" Sh.P.K. garanci kontrate	114,168	K33219201C
Firma "NIKITA SH.P.K. garanci kontrate	17,257	L43003201S
Firma "DUSHK-E-K-SECURITY Elbasan	7198	J63001203S

#### 10 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Paga personeli	0	0
Sigurime Shoqërore dhe te Ngjashme	354,940	350,940
<b>TOTAL</b>	<b>354,940</b>	<b>350,940</b>

#### 11. Të pagueshme për detyrime tatimore

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Shteti - Tatim mbi paga	43,732	88,314
Tatim ne burim	11,932	12,812
<b>TOTAL</b>	<b>55,664</b>	<b>101,126</b>

#### 12. Të pagueshme të tjera

Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
Ortake Dividente per tu paguar	6,042,759	6,042,759
Huamarrje afatshkurtesra	6,901,572	1,908,770
<b>TOTAL</b>	<b>12,944,331</b>	<b>7,951,529</b>

Në këtë rubrikë janë paraqitur detyrimet ndaj aksionarit të vetëm për dividendë të papaguar si dhe hua të tjera afatshkurtra të marra nga ndërmarrje të tjera shtetërore (4,901,570 nga ALBPETROL SH.A dhe 2,000,000 Shpeshkronja e Letrave me Vlere Tiane) për mbulimin e nevojave për likuiditet.

#### 13. Kapitali

Gjendja e kapitalit me datë 31.12.2019 nuk ka ndryshuar as në strukturë dhe as në vlerë në krahasim me gjendjen me 31.12.2018 prej 817,100,000 Lekë.

Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të vetëm nr. 6925/1 datë 19.06.2019, është miratuar rezultati financiar (Humbja) i vitit 2018 prej -10,059,921 Lekë, si dhe janë miratuar pasqyrat financiare të vitit 2018. Humbja e vitit 2018 është mbartur dhe është paraqitur së bashku me humbjet e viteve të tjera.

Vlera e Primeve të kapitalit nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin 2018.

#### 14. Të ardhurat

Gjithashtu në këtë rubrikë janë paraqitur të ardhurat nga veprimtaria operacionale e shoqërisë.

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Nga shitja e mallrave	232,185	0
Të ardhura nga qiradhenia	1,078,632	1,043,042
Të ardhura nga ndihma shtetërore	6,109,449	7,000,000
<b>TOTAL</b>	<b>7,420,266</b>	<b>8,043,042</b>

#### 15. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Inventare te shitur dhe materiale te konsumuara	496,081	314,778
	<b>496,081</b>	<b>314,778</b>

Në këtë rubrike janë paraqitur kostot e inventarëve të shitur dhe të konsumuar gjatë vitit për nevoja të shoqërisë.

#### 16. Shpenzime të personelit

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Paga dhe shpenzime	7,810,709	8,004,000
Shpenzime të sig. shoq/shend	1,304,388	1,346,688
<b>Totali</b>	<b>9,115,097</b>	<b>9,350,688</b>

Numri i punonjësve: 11 punonjës 11 punonjës

#### 17. Shpenzime administrative

Në tabelën në vijim janë paraqitur shpenzimet e kryera nga shoqëria në funksion të aktivitetit tregtar, të klasifikuara sipas natyrës.

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Energji elektrike+uqe	101,586	61,766
Sherbim roje	2,212,156	4,095,722
Qira për buxhetin e shtetit	323,593	332,105
Shpenzime per ekspertet	334,000	334,000
Shpenzime te tjera	48,250	121,988
udhëtime, dieta	69,000	76,200
Shpenzime postare,internet,telefoni fix	107,934	106,793
Shpenzime per sherbime bankare	14,953	16,726
Taksa dhe tarifa vendore	65,220	195,660
Paga per Keshillin Mbikqyres	1,085,167	1,157,040
Shpenzime te tjera	30,000	113,000
Gjoha te ndryshme	547	48,610
<b>TOTAL</b>	<b>4,392,406</b>	<b>6,659,609</b>

#### 18. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin




Në këtë tabelë janë paraqitur llogaritjet për tatim fitimin e vitit 2019.

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Total te ardhura	7,420,266	8,043,042
Total shpenzime	-15,464,361	-18,102,963
Humbja e vitit	-8,044,095	-10,059,921
Shpenzime te pazbritshme	547	48,610
Pemlëtime e gjoba	547	48,610
Fitimi tatimor i ushtrimit/ Humbje	-8,043,548	-10,011,311
Tatim fitimi	0	0
Humbja e vitit	-8,044,095	(10,059,921)

Sikurse shihet nga tabela e mesiperme, shoqëria rezulton me Humbje dhe si rezultat num llogaritjet tatim fitimi për vitin 2019.

#### 19. Palët e lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike.

Palët e lidhur është Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Likuidatori dhe Këshilli Mbikqyrës.

Gjate vitit 2019 shoqëria ka paguar pagë vjetore bruto për Likuidatorin për shumën 1,176,000 Lekë dhe honorare bruto për Këshillin Mbikqyrës me vlerë 1,085,167 Lekë.

#### 20. Honoraret për audituesit


Vlera e honorareve për tu paguar për të dy audituesit, për shërbimin e auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2019 është 282,000 Lekë pa tvsh, plus tvsh 20% me vlerë 56,400 Leke, në total 338,400 Lekë.

#### 21. Ngjarjet pas datës së raportimit

Deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare me datë 6.05.2020 nuk ka patur ngjarje të cilat të ndikonin në gjendjet e deklaruara nga shoqëria me datë 31.12.2019 dhe në shënimet shpjeguese të përfshira në këto pasqyra.

Pasqyrat financiare janë autorizuar nga likuidatori i shoqërisë me datë 10.02.2020

Financier  
 Vilma Ballkaniku






## RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR

Drejtuar: **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, AKSIONAR I VETËM, DHE DREJTIMIT TË SHOQËRISË "KOMBINATI ENERGJITIK" SH.A. NË LIKUIDIM**

Rajoni i Metalurgjisë, Elbasan, Shqipëri

### **Opinion me rezervë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të shoqërisë tregtare "KOMBINATI ENERGJITIK" SH.A. me NUIS J62903209H, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën performancës dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.


Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të paraqitura në bazat për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2019, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### **Baza për Opinionin me rezervë**

1. Shoqëria harton pasqyrat financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK nr.1 "Kudri i Përgjithshëm Për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare" shoqëria duhet të përgatisë pasqyrat financiare në bazë të parimit të likuidimit, pasi me datë 11/06/2015 shoqëria ka publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Urdhërin nr. 4299 datë 26.05.2015, me anë të të cilit është vendosur për prishjen e Shoqërisë dhe fillimin e procedurave të likuidimit. Gjatë kryerjes së procedurave të auditimit ne konstatuam se shoqëria nuk i ka përgatitur pasqyrat financiare sipas këtij parimi. Ne konstatuam që pavarësisht kohës kur ka filluar ky proces, hapave të ngadalta dhe vështirësive të procesit, shoqëria nuk ka ndryshuar bazën e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve në bazë të parimit të likuidimit, çka sjell që vlerat e raportuara në këto pasqyra financiare të mos pasqyrojnë vlerat reale.
2. Në vijim të efekteve që sjell moszbatimi i SKK 1, Shoqëria ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, në shënimin nr.5, Llogari të arkëtueshme tregtare (klientë), vlerësuar me kosta, me vlerë 193.021.505 Lekë, (31.12.2018: 192.932.119 Lekë), të cilat janë krijuar gjatë periudhës viti 2003-2006. Sibatat e klientëve është e ndryshme: nuk zhvillojnë aktivitet, nuk kanë adresa, kanë kaluar në regjistrin pasiv, janë mbyllur, pasqyrojnë veprime të regjistruara jo sakte në ditat, etj.

Pavarësisht përpjekjeve të manaxhimit, nuk është realizuar arkëtimi i tyre as me procedura normale dhe as me procedura ligjore, por njëkohësisht nuk është kryer as zhvlerësimi i tyre sipas kërkesave të SKK-vë. Si rezultat i rëndësisë së kësaj rubrike, e cila zë 46.3% e totalit të aktivitet, nëse Shoqëria do të kishte kryer veprimet e duhura rregulluese, duke ndryshuar bazën e vlerësimit nga kosta në vlerën e rikupertueshme, aktivitet duhet të ishin reduktimin dhe po ashtu Humbja e vitit do të ishte rritur me vlerën përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme po ju paraqisim evidencën për klientët me vlerat më të rëndësishme:



Nr. Emertimi	31.12.2019	Ne % ndaj totalit	31.12.2018	Ne % ndaj totalit
1 N.P.Ç Elbasan	100,887,883	52.27%	100,887,883	52.29%
2 Uzina e Ferrokromit Elbasan	76,459,858	39.61%	76,459,858	39.63%
3 Uzina e Materialeve Refraktare Elbasan	3,168,925	1.64%	3,168,925	1.64%
4 Nd/ja Prodhim Mat.Ndertimit Elbasan	3,035,995	1.57%	3,035,995	1.57%
5 Uzina Karbonike Elbasan	2,970,430	1.54%	2,970,430	1.54%
6 Nd/ja Ujesjelles Elbasan	1,064,359	0.55%	1,064,359	0.55%
7 Nd/ja Energjitike Elbasan	866,144	0.45%	866,144	0.45%
8 Konsumator familjar telefoni	760,387	0.39%	760,387	0.39%
9 Te tjere ne grup (70 kliente)	3,807,524	1.97%	3,718,138	1.93%
<b>TOTAL</b>	<b>193,021,505</b>	<b>100.00%</b>	<b>192,932,119</b>	<b>100.00%</b>

- Shoqëria ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, në shënimin nr.6, Llogari të tjera të arkëtueshme, me vlerë 19,635,998 Lekë, (31.12.2018: 16,144,715 Lekë), nga e cila shuma prej 17,311,652 Lekë (31.12.2018: 14,311,652 Lekë ) përfaqëson Debitorë të ndryshëm (ndërmjet tyre NPC për shumën 3,000,000 Lekë, e cila është njëkohësisht edhe klient) të krijuar në periudhën viti 1999-2006 apo më vonë, si dhe pagesa të kryera per Zyrën e Përmbarimit për ndjekjen e debitorëve. Shoqëria e ka vlerësuar këtë rubrikë me kosto, ndërsa duhet të ishte vlerësuar me vlerën e rikuperueshme, vlerësim i cila influencon si në aktiv (reduktimin e tij)ashtu edhe në Humbjen e vitit (rritjen e saj) dhe në pasqyrat e tjera financiare.
- Shoqëria ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, në shënimin nr.6 " Llogari të tjera të arkëtueshme", Kërkesa ndaj shtetit per tvsh, me vlerë 2,324,345 Lekë, (31.12.2018: 1,883,063 Lekë). Meqenëse gjatë vitit 2019 shoqëria ka ushtruar aktivitetin e qiradhënies, si aktivitet i përjashtuar nga TVSH-ja, atëherë në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSF", Neni 71, tvsh me vlerë 440,572 Lekë, duhet të kalojë në shpenzime të vitit dhe jo si kërkesë për arketim.
- Për shkak të emërimit tonë në Shkurt 2020 (pas mbylljes së vitit 2019) dhe për shkak të situatës së Covid-19, ne nuk mundëm të merrim pjesë në inventarizimin fizik të kryer nga shoqëria. Ne morëm të mirëqenë evidencën e marre nga Shoqëria, e cila ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, në shënimin nr.7 "Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme", inventar me vlerë 31,225,221 Lekë (31.12.2018: 31,454,282 Lekë). Shoqëria e ka vlerësuar këtë rubrikë me kosto, ndërsa duhet të ishte vlerësuar me vlerën e rikuperueshme, vlerësim i cila influencon si në aktiv (reduktimin e tij)ashtu edhe në Humbjen e vitit (rritjen e saj) dhe në pasqyrat e tjera financiare.
- Shoqëria ka paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2019, në shënimin nr.8 "Aktive afatgjata materiale", inventarë me vlerë 169,843,898 Lekë (31.12.2018: 171,304, 676 Lekë), të cilat përbëhen nga pasuritë e mëposhtme të klasifikuara sipas natyrës, pjesa më e rëndësishme e të cilave, përfaqëson pasuri të dhëna me koncension, si vijon:

Nr. Emertimi	31.12.2019	31.12.2018
1 Toka dhe ndertesa	55,985,056	55,985,056
Nga kjo :Dhene me koncension	9,652,000	9,652,000
2 Ndertesa	67,095,499	67,339,120
Nga kjo :Dhene me koncension	62,466,715	62,466,715
3 Impiante dhe makineri	46,381,763	47,520,590
Nga kjo :Dhene me koncension	41,826,456	41,826,456
4 Te tjera instalime dhe pajisje	381,580	459,910
Nga kjo :Dhene me koncension	68,262	68,262
<b>Totali ne pasqyra financiare</b>	<b>169,843,898</b>	<b>171,304,676</b>
<b>Nga e cila dhene me koncension</b>	<b>114,013,433</b>	<b>114,013,433</b>
<b>Koncensionit ne %</b>	<b>67%</b>	<b>67%</b>

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

Referuar pasqyrës së performancës, gjatë vitit 2019 Shoqëria ka realizuar Të ardhura nga dhënia me qira pasurive pronë e saj, me vlerë 1,078,632 Lekë (viti 2018: 1,043,042 Lekë), vlerë e cila ka ardhur në rënie krahasuar me vitet e mëparshme. Ky fakt tregon që aktivet janë zhvlerësuar, process i cili nuk është reflektuar as në këto pasqyra financiare dhe nëse do të reflektohej, shoqëria duhej të njihte Humbjet përkatëse.

7. Sikurse evidentuam në pikën 6 të këtij raporti, Shoqëria ka dhënë me koncesion pasuri me vlerë 114,013,433 Lekë, në bazë të Marrëveshjes se koncesionit te formes "ROT" ndermjet Ministrise së Industrise dhe të Energjetikës e Ministrise se Ekonomise dhe shoqërisë "Kurum International" sh.p.k., për fabrikën e oksigjenit në Elbasan me afat 30 vjet (Qershor 2004-Qershor 2034). Sipas kontratës, Palët kanë rënë dakord të bashkëpunojnë për realizimin e projektit te rehabilitimit te fabrikës se oksigjenit Elbasan, sipas planbiznesit te paraqitur me koncesion te formës "ROT" (rehabilitim-shfrytëzim-transferim), ku në Neni 2 "Objekti i koncesionit" është parashikuar si vijin:

*Objekti i kësaj Marrëveshjeje është dhënia me koncesion e fabrikës se oksigjenit Elbasan, ne formën "ROT" (rehabilitim-shfrytëzim-transferim). Transferim shtetit te teresisë fizike dhe asetëve te ristrukturuara te objekteve ne gjendje pune ne përfundim te periudhës se koncesionit.*

Sa më lart sqaruar dhe në kushtet kur Shoqëria vijon procedurat e likuidimit, ju sjellim në vëmendje që kjo rubrikë e pasqyrave financiare kërkon një trajtim ndryshe, krahasuar më aktivet e tjera për të cilat shoqëria nuk ka detyrime kontraktore.

Po në këtë aspekt, ju sjellim në vëmendje trajtimin me kujdes të kontratave të qirasë operationale afatgjatë, të cilat pavarësisht vlerës jo te rëndësishme, tejkalojnë kohëzgjatjen e Shoqërisë dhe mbyllja e tyre gjatë procesit të likuidimit kërkon një zgjidhje juridike.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Profesionistëve Kontabël i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbytur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. ,

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

#### Cështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 2018, janë audituar nga auditues të tjerë, të cilët kanë shprehur një pinion të modifikuar për to.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.


Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:



J.3

